

Në bazë të nenit 141, 142, 143, 144, 145 dhe 146 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Tuzit („Fleta zyrtare e MZ – dispozitat e komunës“, nr.29/19) p u b l i k o h e t

FTESA

ORGANIZATAVE JOQEVERITARE PËR PARAQITJEN E PJESËMARRJES NË SEANCËN E XVII TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT

Ftohen organizatat joqeveritare me seli në Komunën e Tuzit, të interesuara për pjesëmarrje në seancën e XVII të Kuvendit të Komunës së Tuzit, të paraparë me 17.06.2021 me fillim në orën 11:00, të dorëzojnë fletëparaqitjen për pjesëmarrje në punën e saj.

Paraqitja për pjesëmarrje në seancën e Kuvendit, organizatat joqeveritare dorëzojnë Kryetarit të Kuvendit, përmes arkivit të Komunës, më së largu 7 dit para mbajtjes së seancës së Kuvendit, me atë që janë të obliguara që të radhisin pikat e rendit të ditës për të cilat paraqiten për pjesëmarrje në seancën.

Përfaqësuesi i organizatës joqeveritare mund të marrë pjesë në punën e seancës së Kuvendit përderisa organizata joqeveritare plotëson kushtet si në vijim:

- të jetë e regjistruar një vit;
- të ketë selinë brenda territorit të Komunës;
- që në vitin e kaluar të ketë realizuar një ose më shumë projekte në Komunë, ose marrë pjesë në më së paku një fushatë publike në Komunë, ose realizuar më së paku dy aksione me rëndësi për Komunën, ose marrë pjesë me propozime konkret në më së paku tre shqyrtime publike të cilat janë realizuar në Komunë;
- që në Statut ka veprimtari të caktuara dhe qëllime të veprimit për fushën e caktuar dhe
- të ketë anëtarët të cilët posedojnë përvojë dhe njohin temën e caktuar, ose ka bashkëpunëtorë të cilët posedojnë referenca profesionale sipas temave të caktuara.

Organizata joqeveritare është e obliguar që, shërbimit të Kuvendit t'i dorëzojë:

- fletëparaqitjen për pjesëmarrje në punën e Kuvendit të nënshkruar nga ana e personit i cili është i autorizuar të përfaqësojë ose prezantoj organizatën joqeveritare, me dokumentacionin në bazë të së cilit përcaktohet përmbushja e kushteve nga neni i kaluar;
- Statutin e organizatës joqeveritare;
- Vendimin mbi themelimin e organizatës joqeveritare;
- Deklaratën e personit të autorizuar për përfaqësim ose prezantim të organizatës joqeveritare që në organin e udhëheqjes nuk ka anëtarë të organeve të partive politike dhe funksionar publik, në kuptim të dispozitave mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të cilët janë të përcaktuar të marrin pjesë në punën e seancës, u dorëzohet ftesa për seancë me material për pikën e rendit të ditës në të cilën marrin pjesë, më së largu 5 ditë para mbajtjes së seancës.

Njoftimi mbi përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilat në pikat e veçanta të rendit të ditës do të marrin pjesë në seancën e Kuvendit, publikohet në faqen e internetit të Kuvendit.

